



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.25, datë 30.04.2007

**PËR
KRIJIMIN E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin Nr.9208, datë 18.03.2004, Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 10, neni 16, pika 2, 3, 4 dhe neni 24, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Krijimin e Komisionit të përhershëm për vlerësimin e pasurive të paluajtshme të përbërë si më poshtë:
 - Tre specialistë të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore.
 - Një specialist (topograf) nga Drejtoria e Urbanistikës Ligjore.
2. Komisioni i mësipërm do të vlerësojë në terren pasuritë e paluajtshme duke vendosur mbi madhësinë e sipërfaqeve të tatueshme në rastet e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë.
3. Detyrat e këtij Komisioni përcaktohen në Shtojcën Nr.1 bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Për kategorinë “Ndërtesa Banimi” të Taksës së Pasurisë, Njësitë Bashkiake në rolin e Agjentit Tatimor autorizohen për kryerjen e verifikimeve në terren duke ngritur Komisione të Posaçme.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Urbanistikës Ligjore dhe Njësitë Bashkiake.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

SOKOL DERVISHAJ